



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	25.08.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Haxhimet FERATI Zyrtar i Prokurimit në Komunën e Leposaviqit
CC:	z. Dragan JABLANOVIQ Kryetar i Komunës së Leposaviqit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI <i>(Signature)</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Furnizim me automjet zyrtar për nevojat e Komunës së Leposaviqit " me numër prokurimi: 641-14-003-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:



Inderuari z. Ferati ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me Tenderin " Furnizim me automjet zyrtar për nevojat e Komunës së Leposaviqit " me numër prokurimi: 641-14-003-121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**O P I N I O N**

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Furnizim me automjet zyrtar për nevojat e Komunës së Leposaviqit " me numër prokurimi: 641-14-003-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Komuna e Leposaviqit si Autoritet kontraktues, përmes zyrës së prokurimit ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull " Furnizim me automjet zyrtar për nevojat e Komunës së Leposaviqit " me numër prokurimi: 641-14-003-121, i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.14.08.2014 në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në fushën e Prokurimit Publik (DPKPP) pranë, Agjencisë kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve të dosjes së këtij tenderi, AKK ka hasur në disa dhëna të cilat nuk janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga ana e Autoritetit kontraktues ka konstatuar të faktet si në vijim:

Autoriteti kontraktues ka përgatitur njoftimin për kontratë me 12.08.2014, ndërsa publikimi i tij është bërë me dt.14.08.2014. Pasi është publikuar njoftimi për kontratë, Operatorët e interesuar ekonomik kanë paraqitur kërkesa për tërheqjen e dosjes së këtij tenderi, mirëpo Zyrtari përgjegjës i Prokurimit i ka njoftuar Operatorët ekonomik se nuk është përgatitur ende dosja e tenderit dhe se të njëjtën do të u 'a dorëzojë më së largu deri me dt.18.08.2014 në ora 15:00 me arsyetimin se Komuna e Leposaviqit duhet ti përgatisë specifimet teknike për automjet. Pasi Agjencia ka iniciuar rastin lidhur me ketë procedurë të prokurimit, zyrtari përgjegjës i prokurimit me dt.15.08.2014 u 'a ka dorëzuar dosjen e tenderit operatorëve ekonomik, veprim ky për të cilin konsiderojmë se është në kundërshtim të plotë me Ligjin e Prokurimit Publik.

Sipas LPP-së "autoriteti kontraktues duhet të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kerkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të përbajë një kopje të njoftimit të tillë dhe informatat e tjera të tillë përkatëse që mund të jenë të nevojshme për të qartësuar dhe plotësuar informatat që gjinden në njoftimin e tillë. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e variantave dhe informatat tjera të rendësishme.

Autoriteti kontraktues do ti parashtrojë të gjitha specifimet e detyrueshme teknike në dosjen e tenderit. Nëse aktiviteti përkatës i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, autoriteti kontraktues (i) do të parashtrojë specifimet e tillë në njoftimin në fjalë, ose (ii) do të dërgojë një deklaratë të qartë që tregon se ku mund të merren specifimet e tillë teknike.

Tek pika III.2.3 e rubrikës **Kapaciteti ekonomik dhe financiar**, autoriteti kontraktues ka kërkuar qarkullim financiar minimum **300 000.<sup>00</sup>** euro. Kërkesë kjo e cila bie ndesh me Udhëzimin administrativ të Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik. Sipas LPP-së dhe Udhëzimit administrativ nr.02/2014 të KRPP-së një Autoritet kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kritereve të përzgjedhjes të kérkojë, dëshmi nga Operatorët ekonomik me të cilat do ta vërtetonte astësinë e tyre ekonomike - financiare, por nuk është e lejuar që si qarkullim financiar të kérkojë shumën e cila e kalon dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në dosjen e tenderit tek pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme dhe kérkesën e njësisë kérkuese, që ka përgatitur A.K. për këtë aktivitet të prokurimit, janë përshkruar disa specifikime si në vijim: Vëllimi i Motorit : 2.2 deri 2. 8 ccm, Fuqia e motorit: Min. 196 KF, **Gjatësia: min 4685mm**, Sistem i Tërheqjes 4X4, Ndërruesi i Shpejtësive: Automatik Minimumi 6 shpejtësi TCS – Kontrollimi elektronik i rrëshqitjes se rrotave DBC – Shpërndarës elektronik i fuqisë frenuese, TPMS (Monitorimi i gjendjes se gomave gomave), Airbag min 6, **Rrote Standarde: Minimumi R19**”, Çelës inteligjent, Kamerë të parkingut dhe senzor të parkingut, Kulmin panorama, **Sistemi i parkingut automatik etj.**

Autoriteti kontraktues më konkretisht njësia kérkuese duhet të ketë kujdes dhe t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të janë hapura për të gjithë Operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë furnizimet e kérkuara me automjete. Autoritetit kontraktues nuk i lejohet që të hartoje specifikime teknike të mangëta duke kërkuar vetëm disa përmasa si: gjatësia e automjetit e jo edhe gjerësia dhe lartësia e automjetit.

Agjencia kundër Korruptionit vëren se si kriter për dhënie të kontratës, autoriteti kontraktues ka përdorur kriterin **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm**, ndërsa si nën kriter i ka vendosur **1. Çmimin** të cilin e ka peshuar me 60 %, **2. Afatin e servisimit** të automjetit duke përfshirë edhe ndërrimin e pjesëve harxhuese (në vite) të cilin i ka caktuar peshë prej 20 %, **3. Afatin e garacionit** në defekte eventuale (në vite dhe km) të cilin e ka peshuar me 10 %, **4. Afatin e garacionit** në defekte dhe korrozion ne karroceri në vite të cilin e ka peshuar me 5 % dhe **5. Afatin e liserimit** të cilin i ka caktuar peshën prej 5%.

Lidhur me nën kriteret 2,3,4 dhe 5 Agjencia kundër Korruptionit konsideron se nën kriteret tilla nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kriter për dhënie të kontratës nga ana e Autoritetit kontraktues.

Autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kritereve të përzgjedhjes dhe kritereve për dhënie të kontratës, sipas ligjeve në fuqi kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdorën në asnjë mënyrë si kriter për dhëni e kontratës, andaj konsiderojmë se nën kriteret e vendosura si më lartë nuk janë kriterë të matshme dhe do duhej të caktoheshin si kriterë minimale për kualifikim.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **7** Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin **27** Dosja e Tenderit, nenin **28** Specifikimet teknike dhe nenin **68** Gjendja Ekonomike dhe Financiare të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin **25** Kriteret e dhënies së kontratës e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe nenin **5** Gjendja ekonomike dhe Financiare e Udhëzimit administrativ Nr.02/2014 të KRPP-së.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tillë në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

DOKUMEN\*